

STATUSI SOCIO-EKONOMIK DHE PËRFSHIRJA NË MOTIVIM,
REZILIENCË DHE PERFEKSIONIZËM TEK ADOLESHENTËT KOSOVARË

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

ELENA CAHANAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

PRISHTINË

JANAR, 2024

Mentore: Kaltrina Kelmendi, Prof. Asoc. Dr.

Statusi socio-ekonomik ndikon në funksionimin e përgjithshëm të njeriut, duke përfshirë shëndetin tonë fizik dhe mendor (American Psychological Association, 2023). Statusi socio-ekonomik (SES) përfshin jo vetëm të ardhurat, por edhe arritjet arsimore, sigurinë financiare dhe perceptimet subjektive të statusit social dhe klasës sociale. SES mund të përfshijë cilësinë e jetës, si dhe mundësitë dhe privilegjet që u ofrohen njerëzve brenda shoqërisë (American Psychological Association, 2023). Varfëria, konkretisht, nuk është një faktor i vetëm, por karakterizohet nga stresorë të shumtë fizikë dhe psikosocialë. Për më tepër, SES është një parashikues i qëndrueshëm dhe i besueshëm i një sërë rezultatesh gjatë gjithë jetës, duke përfshirë shëndetin fizik dhe psikologjik. Kështu, SES është i rëndësishëm për të gjitha sferat e shkencës së sjelljes dhe sociale, duke përfshirë kërkimin, praktikën, edukimin dhe avokimin (American Psychological Association, 2023). Statusi socio-ekonomik përfshirjen e tij e ka të shpërndarë në shumë aspekte psikologjike të jetës së njeriut, duke pasur ndërlidhje me shumë aspekte social-kognitive të njeriut (Bandura, 1993).

Kur flasim për sfera të rëndësishme psikologjike me rëndësi në jetën njerëzore prej tyre është dhe rezilienca. Rezilienca është një konstrukt psikologjik i shumëanshëm që ngërthen aftësinë e një individi për t'u përshtatur dhe për të ecur përpara pavarësisht nga stresi dhe fatkeqësia (Wu et al., 2013). Duke qënë një nga shtysat për të shkuar përpara si qenie njerëzore motivacioni është pjesë kryesore e studentëve në gjithë botën që nga shkollimi parafillor e vazhdimisht gjatë jetës, edhe pse nuk diskutohet aq shumë sa akterë të tjerë ndikues (The George Washington University, 2012). Motivacioni është forcë që shkakton tek njerëzit të sillen në një mënyrë të caktuar, kurdo që ndodh një ngjarje e caktuar që jep drejtim dhe fuqi një sjellje nehyjmë në territorin e motivacionit (Tohidi, 2012).

Statusi socio-ekonomik që është perceptuar më i ulët sesa mesatarja nga pjesëmarrës të hulumtimit ka treguar reziliencën si faktor të lartë të pjesëmarrësit, duke rezultuar dhe ndërmjetësues mes të SES dhe shëndetit mendor (Wippold et al, 2020). Studentët me SES të lartë priren të shfaqin modele dhe sjellje të caktuara motivuese që ndryshojnë nga homologët e tyre të SES më të ulët, duke reflektuar ndikimin e prejardhjes së tyre sociale dhe ekonomike. Studentët me SES të lartë shpesh demonstrojnë një nivel më të lartë përpjekjesh në ndjekjet e tyre

akademike. Kjo mund t'i atribuohet disa faktorëve, duke përfshirë aksesin në burime më të mira arsimore, një mjedis mbështetës në shtëpi dhe një perceptim se suksesi akademik është thelbësor për mundësitë e ardhshme, duke qenë më perfeksionistë në kryerjen e përgjegjësive të tyre (Shin & So, 2018). Duke u përmendur implikimet signifikante në punësim e karrierë në këtë fazë zhvillimi, presioni për të qenë në nivel dhe pa u larguar nga kërkesat e familjes dhe treguat tek të rinjtë shfaqet dhe perfeksionizmi. Perfeksionizmi është një prirje e shumëanshme e personalitetit e karakterizuar nga një kërkim i palëkundur, i patëmetë dhe vendosja e standardeve jashtëzakonisht të larta për performancën, shpesh të shoqëruar nga një prirje për vetëvlerësime tepër kritike (Flett dhe Hewitt 2002; Frost et al. 1990).

Kryerja e një studimi mbi statusin socio-ekonomik dhe lidhjen e tij me motivimin, reziliencën dhe perfeksionizmin në një vend të vogël, veçanërisht kur shumica e popullsisë përbëhet nga rinia, ka një rëndësi të madhe. Në një kontekst të tillë, ku peizazhi demografik është kryesisht rinor, të kuptuarit e ndërveprimit midis faktorëve socio-ekonomikë dhe dimensioneve psikologjike bëhet thelbësore për ndërhyrjet e synuara. Çka e tregon rëndësinë e hulumtimit të mëtutjeshëm të këtyre komponentëve së bashku, sidomos në një vend si Kosova ku numri i lartë i të rinjve mbizotëron në popullësi dhe ka ndryshime në raport me statusin socio-ekonomik në mes të popullsisë (Agjensia e Statistikave të Kosovës, 2011) është një arsye shtesë për të gjetur ndikimin e këtij të fundit tek të rinjtë kosovarë në vendin tonë. Hulumtimet e bëra në Kosovë kanë përkuar me gjetjet në vendet e tjera fqinje në lidhje me statusin socio-ekonomik dhe motivimin, ku adoleshentët të cilët kanë status më të ulët socio-ekonomik kanë treguar pikë më të ulëta në motivim, distres psikologjik më të lartë dhe vetë-vlerësim më të ulët (World Health Organisation, 2014). Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizojë ndikimin e kushteve socio-ekonomike në adoleshentët kosovarë në lidhje me motivimin, përfshirë këtu ndërveprimin kompleks midis kushteve socio-ekonomike dhe nivelit të motivimit me fenomenin e perfeksionizmit. Përveç kësaj, hulumtimi synon të kuptojë se si kushtet socio-ekonomike ndikojnë në nivelin e reziliencës tek adoleshentët.

Duke u bazuar në këto të fundit, pyetjet kërkimore që ngriten në këtë hulumtim janë:

Pyetja kërkimore 1: Si ndikon statusi socio-ekonomik në motivim tek adoleshentët kosovarë?

Pyetja kërkimore 2: Cili është ndikimi i statusit socio-ekonomik në reziliencë tek adoleshentët kosovarë?

Pyetja kërkimore 3: Si është ndërlidhja e statusit socio-ekonomik dhe motivimin në raport me perfeksionizmin tek adoleshentët kosovarë?

Kur flasim për kornizën teorike të hulumtimit, teoria social kognitive është teori psikologjike e zhvilluar nga Albert Bandura në mesin e viteve të 70ta (Jenkins, Hall & Raeside, 2018). Kjo teori shpjegon sesi individët brenda sistemeve sociale incojnë procese të shumta njerëzore duke përfshirë përdorimin dhe përshtatjen e informacionit dhe dijes për nevojat e tyre. Fokusi kryesor është procesi i të mësuarit dhe ndërveprimi i shumë faktorëve në mes (Jenkins, Hall & Raeside, 2018). Në teorinë social kognitive të Bandurës njerëzit nuk janë të udhëhequr automatikisht as nga forcat e brendshme dhe as nuk janë të formuar nga mjedisi ku ata jetojnë, siç është parë deri më tani dy të fundit veprojnë si të ndërlidhura bashkë që kontribuojnë tek motivimi i njerëzve, sjellja dhe zhvillimi i tyre duke ndikuar në mënyrë reciproke (Bandura, 1989). Statusi socio-ekonomik ndikon aspiratat e njerëzve, sa shumë mundohen ti arrijnë qëllimet e tyre, si ndihen gjatë procesit dhe sa insistojnë në kryerjen e qëllimeve të ktyre, duke treguar relevancë të lartë aspektit ekonomik dhe zhvillimit të tij në motivimin e njerëzve për kryerjen e qëllimeve të tyre (Bandura, 1977; Bandura 1997; Bandura 2012; Wuepper & Lybbert, 2017).

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës hipotezat e ngritura për hulumtim janë:

Hipoteza 1: Adoleshentët me status më të lartë socio-ekonomik kanë motivim të brendshëm më të lartë sesa adoleshentët me status më të ulët socio-ekonomik.

Hipoteza 2: Adoleshentët me status më të ulët socio-ekonomik kanë reziliencë me të ulët sesa adoleshentët me status më të lartë socio-ekonomik.

Hipoteza 3: Adoleshentët të cilët kanë status më të lartë socio-ekonomik dhe motivim të brendshëm më të lartë janë më perfeksionistë sesa adoleshentët me status më të ulët socio-ekonomik dhe motivim të brendshëm.

Nëhipoteza 3.1 : Ekziston korrelacion në mes të motivimit me edukimin e lartë të prindërve tek adoleshentët kosovarë.

Nëhipoteza 3.2 : Ekziston korrelacion në mes të perfeksionizmit me edukimin e lartë të prindërve tek adoleshentët kosovarë.

Nëhipoteza 3.3 : Ekziston korrelacion në mes të motivimit me punesimin e prindëve tek adoleshentët kosovarë.

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 300 nxënës të shkollave të mesme të shpërndarë në komunën e Prizrenit dhe Prishtinës, të cilët janë përzgjedhur me anë të mostrës probabile. Një mostër probabiliteti i referohet një kampioni të nxjerrë nga një popullatë duke përdorur një metodë që i jep çdo elementi në popullatë një probabilitet të njohur dhe jo zero për t'u përzgjedhur. Mbledhja e të dhënave për tu analizuar më pas është kryer përmes pyetësorëve, që janë një seri pyetjesh që i parashtrihen individëve që përmbajnë informacione të dobishme statistikore për një qështje të caktuar (Roopa & Satya, 2012). Instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave janë : Inventari i Motivimit të Brendshëm, ky instrument përfshin 7 nëndarje varësisht prej qëllimit të hulumtimeve që përbëhen nga 45 qëndrime që i takojnë nëndarjeve të përmendura (Ryan, Mims & Koestner, 1983), pyetësori i Statusit Socio-Ekonomik (SES), ky pyetësor përfshin 6 faktorë me pyetje nga historia e edukimit, vendi ku jetojnë (shtëpi, banesë), profesioni, të ardhurat, udhëtimet dhe patundshmëria (Fehintola, 2020), Pyetësori i Perfeksionizmit (Bento, Pereira, Saraiva, & Macedo, 2014) është një vetë-raportim dhe pyetësor i përbërë nga 22 artikuj të bazuar në një konceptualizim shumëdimensional i perfeksionizmit dhe Pyetësori i reziliencës i Nicholson BcBride, versioni i shkurtër me 12 deklaratë do të përdoret. Ku për secilën deklaratë pikëzohen nga 1 deri në 5, ku 1 është fuqimisht nuk pajtohem deri në 5 që është fuqimisht pajtohem.

Rezultatet e dala nga hulumtimi kanë vërtetuar hipotezat tona ku është konfirmuar se adoleshentët me SES më të lartë tregojnë motivim të lartë ($p < .0001$), ndërsa ata me SES më të ulët kanë rezultate më të ulta. Po ashtu, adoleshentët me SES të lartë shfaqin reziliencë më të madhe ($p < .001$). Analizat regresionare konfirmojnë se ata me SES dhe motivim më të lartë janë më perfeksionistë ($p < .0001$). Nëhipotezat tregojnë korrelacion ndërmjet motivimit, edukimit, punësimit të prindërve dhe perfeksionizmit. Ky studim hedh dritë mbi rëndësinë e SES në formimin e karakteristikave psikologjike të adoleshentëve, duke identifikuar lidhjet komplekse midis këtyre dimensioneve.

Rekomandimet e dala nga hulumtimi bazohen në ndërlidhjen e rëndësishme të variablave me fazës e adoleshencës dhe impaktet e tyre në ndërtimin e personalitetit. Specifikat e rekomandimeve për hulumtimet e ardhshme janë ndërtuar mbi shqyrtimin e literaturës përgjatë

hulumtimit e shembujve konkret të përdorur në hulumtimet e kryer në vendet fqinje të Evropës dhe më gjerë. Hulumtimi gjithashtu ka dhe limitimet e veta ku të adresuarit e limitimeve në hartimin dhe metodologjinë e studimit mund të forcojë qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e gjetjeve, duke ofruar një portret më të saktë të ndërveprimit kompleks midis statusit socio-ekonomik, reziliencës, motivimit dhe perfeksionizmit tek adoleshentët. Si përfundim, gjetjet e këtij studimi vënë theksin një marrëdhënie bindëse midis statusit socio-ekonomik dhe faktorëve kyç psikologjikë si motivimi, rezilienca dhe perfeksionizmi. Të dhënat sugjerojnë fuqimisht se individët me një status më të lartë socio-ekonomik priren të shfaqin nivele të larta motivimi, reziliencë më të madh përballë sfidave dhe një tendencë drejtë perfeksionizmit. Kjo përfshirje nënvizon ndërveprimin e ndërlikuar midis faktorëve socio-ekonomikë dhe attributeve psikologjike, duke hedhur dritë mbi dinamikat komplekse që ndikojnë në mentalitetin dhe sjelljen e një individi. Implikimet e këtyre rezultateve shtrihen përtej sferës akademike, duke pasur një rëndësi të konsiderueshme për politikëbërësit, edukatorët dhe profesionistët e shëndetit mendor.